

Abstrakt

Dhuna në familje dhe dhuna ndaj gruas nuk është një problem familjar-privat por është një nga fenomenet më negative në shoqërinë tonë, kjo për faktin sepse ka të bëjë me pabarazinë në bazë të seksit e duke shkuar deri në atë pikë të diskriminimit në bazë të gjinisë. Padyshim të gjithë jemi dëshmitar që kohët e fundit numri i rasteve të dhunës në familje është në rritje enorme çdo ditë e më shumë. Madje shumë prej tyre mbesin të paraportuara si rezultat i shumë faktorëve, të cilët do të trajtohen në këtë punim.

Fatkeqësisht shumë raste të dhunës në familje kanë përfunduar me pasoja fatale për viktimën, duke e privuar atë nga një e drejtë fundamentale, saktësisht nga e drejta për jetë. Janë ende të paqarta shkaqet mbi rritjen e kësaj dukurie, ku nuk dihet a është rritur dhuna në familje dhe dhuna ndaj gruas si një fenomen dhe dukuri apo është rritur vetëdija e popullit mbi denoncimin e këtyre rasteve pranë institucioneve kompetente.

Shumë hulumtues kanë filluar hulumtimet e tyre lidhur me shkaqet dhe pasojat e këtij fenomeni, si dhe përpjekjeve për parandalim. Por sa po parandalohet kjo? Përgjigja lë shumë për të dëshiruar, kjo sepse ekziston një zinxhir i gjatë i faktorëve të ndryshëm siç janë faktori ekonomik, social, kulturor etj. Praktika ka treguar që institucionet në shumë raste kanë dështuar ta parandalojnë dhunën në familje dhe atë nëpërmjet mosveprimit dhe mosndërmarrjes së masave adekuate. Për më tepër duke qenë në dijeni për një rrezik real.

Çka përkufizon realisht dhuna në familje, kush është viktimë dhe kush është kryerës i dhunës në familje? Nuk ka ndonjë përkufizim të përgjithshëm, sepse, secili shtet në legjislacionin e vet e përcakton si definim me fjalë të ndryshme. Në Republikën e Kosovës përkufizohet si çdo lloj veprimi i qëllimshëm apo mosveprim që rezulton me keqtrajtim, ku kryhet nga një person, i cili është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën.

Ndërsa viktimë mund të jetë çdo person që merr ndonjë keqtrajtim nga veprimet e veprës penale; dhunë në familje. Për dallim nga dhuna ndaj gruas, e cila është dhunë me elemente diskriminuese për shkak të gjinisë, dhuna në familje mund të ndodhë nga çdo gjini, fe, moshë, orientim seksual, bindje politike etj.

Kurse kryes i veprës penale të dhunës në familje dhe dhunës ndaj gruas është çdo person, i cili me veprimet apo mosveprimet e tij kryen një akt të tillë.